

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuares M. A. nga fsh. S., Komuna Lipjan, të cilën e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.1756/16 të dt.02.03.2017, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 KPRK-së, në shqyrtim gjyqësor publik, të mbajtur me dt.25.04.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit B. I., dhe të akuzuares, me dt.25.04.2018 merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

M. A., e bija e V. dhe Xh.,e gjinisë P., me vendbanim në fsh.G. e E.e, Komuna e Lipjan, amvise, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, ka kryer shkollën fillore, me nr. personal *numri personal...* dhe nr. tel *numri i telefonit...*,shtetase e Republikës së Kosoves,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse :

Me datën 29.12.2015 rreth orës 19:00-19:15 në Lipjan, saktësisht në Motelin “L.” e pandehura pastruese e Motelit me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm nga dhoma e Motelit ku kishte banuar I. S. ia kishte vjedhur telefonin e tipit Samsung S6, me ngjyrë të badhë, në vlerë prej 300€, Ii cili kishte të vendosur SIM kartelen me nr. *numri i telefonit...*,të valës, një zingjirë dore dhe një palë vath ari, me ç’rast të dëmturit i ka shkaktuar dën material,-

- Me këtë ka kryer veprë penale Vjedhja nga neni 325 par. 1 të KPRK-së

Andaj gjykata konform neneve 1,2,4,6,41,42,46,49,50,51,52 dhe nenit 325 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej një viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftëse i dënuari nuk kryen veprë tjetër penale në afat prej 1 viti dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200.-€, (dyqindëeuro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afatin e caktuar, konform nenit 46 të KPRK-së dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ku do të llogaritet shuma prej 20 €.- për një ditë burgimi.

I Demtuari- I. S. nga Lipjani, punptor np Gjermani me nr. personal *numri personal...* dhe me nr. tel. *numri i telefonit...*,për kërkesën pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil.

DETYROHET e akuzuarjaa që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i’a paguajë shumën prej 20.-€, dhe 30.-€ në Fondin e Viktimave të krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.1756/16 të dt.02.03.2017 e ka akuzuar të pandehurin M. A. nga fsh. G. e E., K.Lipjan, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin e dytë gjyqësor ka deklaruar se e pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehures sepse një pranim i tillë është i mbështetur në provat që i përmban akti akuzues dhe i propozon gjykatës që të njejtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

E pandehura në shqyrtimin e dytë gjyqësor ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se është e sëmurë, burrin e ka të paralizuar për qka i duhet të kujdeset për të dhe fëmijët dhe të gjitha këto rrethana të vështira e kan shtyer të gabon por i premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje te tilla për qka i propozoj gjykatës që të më shqipton një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi që bindet se E pandehura e ka kuptur natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 248 të KPPRK-së se gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, faktin se e pandehura për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, gjendjen e vështirë ekonomike, është mbajtëse e familjes, sjelljen e të pandehures gjatë shqyrtimit gjyqësor, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme, e veçanarisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehures, e në mungesë të rrethanave renduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoj dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të bëjë kompenzimin e palës së dëmtuar si dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit si dhe konform nenit 50 të KPRK-së që parasheh që dënimi të mos zbatohet për veprat e lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej veprën penale.

Vendimi për paushallin gjyqësor u bazua në nenin 450 par.1 dhe 2 nën par. 6 të KPRK-së si dhe shuma për kompenzimin në Fondin e viktimave u bazua në nenin 39 të Ligjit për mbojtjen e viktimave te krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIHTINË DEGA NË LIPJAN.

P.nr.193/17 me dt.24.04.2018

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate